



VENDIM

Nr. 68, Datë 27.05.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË “RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16; 81 pika 2, 99 dhe 110 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM Nr. 244, Date 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.05.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me “Miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të energjisë elektrike” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar,

Konstatohet se :

Në datë 30.03.2016 Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”

- Në nenin 99 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: *“Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.”*
- Në nenin 14, pika 1 të VKM 244 Date 30.03.2016, është parashikuar se *“Këto rregulla do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë*

elektrike, deri në miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për Miratimin e një ndryshimi në "Rregullat e Tregut miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 68, Date 23.06.2008 si më poshtë:

Në kapitullin IX. Pika 1.3 gërma g, ndryshon me përmbajtjen si më poshtë :

- a) "Duke filluar nga 1 Korriku 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike, me përjashtim të subjekteve të përcaktuar në Ligjin nr. 138/2013 "Për burimet e rinovueshme dhe sipas pikës 4 të nenit 99 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike."
 - b) Klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal nuk janë përgjegjës për disbalancat kundrejt këtij të fundit.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a, dhe palet e tjera të interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI